



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.686/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesuese, Ymer Hoxha dhe Zyhdi Haziri anëtarë, me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjore Anita Peci, duke vendosur përkitazi me apelet e Gjylfidane Sylaj, kandidate për anëtare të Kuvendit Komunal në Klinë, nga radhët e subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), dega në Klinë, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017, për shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarë të Kuvendit Komunal të mbajtura më datë 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur më datë 12.11.2017, mori këtë:

V E N D I M

I. Pranohen si të bazuara apelet e kandidates për anëtare të Kuvendit Komunal në Komunën e Klinës, Gjylfidane Sylaj, nga radhët e subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), dega në Klinë, me shenjat ZL.Anr.686, ZL.Anr.687 dhe ZL.Anr.688, të datës 09.11.2017, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017 pas shpalljes së rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarë të Kuvendit Komunal të mbajtura më datë 22.10.2017.

II. Urdhërohet Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) që të rinumëroj vetëm fletëvotimet për kandidaten për anëtare të Kuvendit Komunal në Klinë, nga radhët e subjektit politik Aleanca Kosova e Re (AAK), Gjylfidane Sylaj në vendvotimet: 0818C/02R, 0807C/02R, 0807C/03R, 0802C/01R.

III. Rezultati i cili del pas rinumërimit të fletëvotimeve në kuti në Vendvotimin si në pikën - II- të këtij dispozitivi, të përfshihen në rezultatin përfundimtar.

A R S Y E T I M

PZAP-i, ka pranuar apelet e vendosura në dispozitiv të këtij vendimi të datës 09.11.2017, nga Gjylfidane Sylaj kandidate për anëtare të Kuvendit Komunal në Komunën e Klinës nga radhët e subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) me seli në Prishtinë. Parashtuesja e apeleve pretendon se në vendvotimet : 0818C/02R, 0807C/02R, 0807C/03R, 0802C/01R e kanë votuar familjar të saj dhe do të duhej të kishte 14 vota, ndërsa nga rezultati përfundimtar rezulton se ajo ka zero (0) vota në këto vendvotime.

Parashtruesja e apeleve si dëshmi ka bashkangjitur deklaratat e familjarëve që e kanë votuar, po ashtu kërkon nga PZAP-i që të bëhet rinumërimi i votave në vendvotimet e cekura.

Paneli, në bazë të nenit 13.2 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, ka bashkuar apelet e lartcekura dhe i trajton si një apel i evidentuar me ZL.Anr.686/2017, për shkak të natyrës së njëjtë të rasteve dhe pretendimeve dhe për tri apele që përmbajnë në vete çështje të ngjashme dhe se ato apele të trajtohen me një vendim i vendosi me një vendim për shkak të efikasitetit dhe ekonomizimit të procedurës.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i shqyrtoj pretendimet ankimore dhe materialin zgjedhor e pas vlerësimit të gjithanshëm të tyre gjeti se:

Apelet janë të bazuara

Paneli gjeti se pretendimet ankimore janë të bazuara, për faktin nga provat që gjenden në shkresat e lëndës, ka vërtetuar se ka mungesë të votave të kandidatës nga subjekti politik AAK, në rezultatet e shpallura nga KQZ-ja në Rezultatin Përfundimtar, andaj mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 117.4 të LZP-së, PZAP-i urdhëron KQZ-në, që të bëhet rinumërimi i të gjitha fletëvotimeve për kandidaten nga radhët e subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) në vendvotimet e cekura më lartë dhe rezultati i dalë nga rinumërimi të përfshihet në rezultatin përfundimtar të Zgjedhjeve Lokale të datës 22.10. 2017.

Andaj PZAP nga këto arsye, dhe në mbështetje të nenit 117.4 urdhëron që të bëhet rinumërimi i fletëvotimeve për vendvotimet e lartcekura si në pikën II të dispozitivit.

PZAP-i vendimin e vet e bazon në dispozitën nenit 119.5 të LZP-së, ku parashihet se, *PZAP-i mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtoj çështje të cilat përndryshe janë nën juridiksionin e tij kur kjo është e domosdoshme për të parandaluar padrejtësi serioze*, nga si u tha mësipër në mbështetje të nenit 117.4, 115.1 dhe 118.1 e LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

ZL.Anr. 686/2017 më datën 12.11.2017.



Këshillë Juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa